

## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "Klo-Kel Konfeksion"SH.P.K

Me kete Statut,Ortaket e Shoqerise:

**1.Z.KLOANDI HANELLI**,i biri i Vasfi,lindur dt.14.06.1993 ne Durres dhe banues ne Sukth i Ri,Durres,me shtetesi shqiptare,i identifikuar me Pashaporte Nr.BR5781913, leshuar me dt. 25.01.2013,me Nr.Personal J30614068W,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,

**2.Zj.ENKELEJDA MARTINAJ**,e bija e Riza,lindur dt.27.11.1979 ne Fllake,Durres dhe banues ne Lagja 14,Shkozet,Durres,me shtetesi shqiptare,e identifikuar me Karte identiteti Nr.037901279, leshuar me dt. 01.11.2021,me Nr.Personal H96127055L,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,

Deklarojne se kane Themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin:

"Klo-Kel Konfeksion"SH.P.K.

#### KREU I

FORMA,EMERTIMI,OBJEKTI,SELIA,KOHEZGJATJA

#### Neni 1

##### FORMA

Shoqeria eshte person juridik i formes "SH.P.K".

Ajo njihet dhe regjistrohet si person juridik ne baze te ligjit shqiptare ne fuqi.

Aktivitetin ajo do ta zhvilloje sipas ketij Statuti,Legjislacionit Shqiptar Tregtar dhe atij Nderkombetar ne fuqi si dhe Legjislacionit te pergjithshem ne fuqi.

#### Neni 2



##### EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte "**Klo-Kel Konfeksion**"SH.P.K

#### Neni 3

##### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte:



-Import – Eksport,Perpunimi dhe Sherbimi i Qepjes se Veshjeve te ndryshme me material porositesi ne Fasoneri (FASON).

*Shoqeria ka te drejte te ushtroje veprimtari edhe ne fushat e meposhtme;*

1.Dhenie me Qera dhe Shit-Blerje te Mjeteve te ndryshme Motorrike brenda dhe jashte vendit si dhe tregtimi me Shumice dhe Pakice i pjeseve te tyre te kembimit.

2.Te zhvilloje aktivitetin ne fushen e Hidrokarbureve,Import-Eksport dhe perpunimi i tyre.

3.Grumbullimi i bimeve industriale dhe Medicinale dhe eksportimi i tyre me shumice dhe pakice.

4.Tregtimi me shumice dhe pakice i Bizhuterive dhe materialeve te tjera me vlere.

5.Prodhim dhe tregtim konfeksionari tekstili dhe kepecari,tregtim me shumice dhe pakice te materialeve industriale,blegtorale,bujqesore dhe mineraleve te ndryshme.

6.Te krijojte lidhje kontraktore ndermjet paleve brenda dhe jashte vendit sipas Legjislacionit ne fuqi.

7. Tregti me shumice e pakice te artikujve te akcizes,ushqimore,industriale,pajisje elektronike apo semielektronike per perdorim tregtar ose familjar,lende ndertimi,ushtrimi i cdo aktiviteti tregtar e komercial te lejueshem qe eshte ne interes te shoqerise.Te zhvilloje dhe te ushtroje aktivitet tregtar dhe/apo fitimprures ne sherbime tregtare restaurant,bar-bufe,hoteleri,pika tregtimi,ambjente zbavitje,argetimi...Te zhvilloje aktivitet publicistik ne cdo forme dhe trajte te tij...

8.Te zhvilloje aktivitetin e ndertimit te veprave te cdo lloji,banesa shumekateshe,qendra tregtare apo sherbimi,ambjente industriale,etj.Te zhvilloje veprimtari ne struktura te organizuara profesionistesh te saj apo te nenkontraktuar sipas rastit.Te zhvilloje aktivitetin e perpunimit te lendes se pare te cdo lloji dhe transformimin e tyre ne produkte e nenprodukte te kerkuara ne treg...

9.Te zhvilloje e te operoje ne format sa me efikase e bashkekohore ne aktivitetin imobiliar...te fitoje tituj pronesie mbi pasuri te luajtshme e te paluajtshme,te fitoje te drejta dhe privilegje mbi pasuri e sende te luajtshme e te paluajtshme,te tjetersoje,te jape me qira apo/dhe te kontraktoje ne cdo forme ligjore mbi te drejtat dhe titujt e pronesise se ketyre pasurive e sendeve...te jete pale kontraktuese per shitjen apo/dhe blerjen per interesat e shoqerise te pasurive te luajtshme e te paluajtshme,te cdo sendi,titulli,te drejte qe komercializohet...

10.Administrimin dhe ushtimin e agjensise spedicionere te mallrave,udhetareve,ne transport tokesor,ujor dhe ajror.Te funksionojte si shoqeri ndermjetesimi,perfaqesimi,service,menaxhimi,punesimi,kembimi valutore etj.

11.Te jete pale dhe te ofroje sherbime dhe produkte nepermjet te gjitha formave te kontraktimit apo prokurimit publik,marreveshjeve apo tratativave tregtare apo/dhe me karakter civil,etj.

12.Ushtrimi i cdo veprimtarie te ligjshme,te lejueshme per formen e shoqerise,e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 te ligjit tregtar nr.9901,dt.14.04.2008)

13.Te zhvilloje aktivitetin ne fushen e peshkimit me anije peshkimi dhe ta tregtoje ate si brenda ashtu dhe jashte vendit.

Neni 4

SELIA

Selia e shoqerise caktohet ne:Korce,Devoll,Bilisht,Zona Kadastrale Nr.1187,Numri i Pasurise 6/210 N2.

Neni 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise caktohet per nje afat te pakufizuar.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR,KONTRIBUTET,PERGJEGJESIA,LEVIZJET E KAPITALIT,KUOTAT DHE KALIMI I TYRE

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Fillestar Themeltar eshte 100.000 (njqindmije) leke.Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e kapitalit te nenshkruar nga ortaku,depozitohen ne Banke ne afatin dhe kushtet qe percaktohen per kete qellim me vendim te zakonshem te shoqerise.

Neni 7

PJESET E KAPITALIT

Kapitali themeltare eshte i ndare ne 2 Kuota me vlere nominale 100.000 leke.

- Ortaku i Shoqerise Z.Kloandi Hanelli disponon 1 kuote me 50 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise me vlere 50.000 Leke.
- Ortaku i Shoqerise Zj.Enkelejda Martinaj disponon 1 kuote me 50 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise me vlere 50.000 Leke.

Pjesa e kapitalit qe kontribuon secili ortak konvertohet ne vlere te barabarte me kuotat qe ai ortak zoterohet ne kapitalin e shoqerise. Kur pjeset e kapitalit zoterohen nga nje person i vetem (fizik ose juridik), shoqeria tregtare vijon te funksionoj si shoqeri me ortak te vetem.

Neni 8

KONTRIBUTET

Kapitali themeltar dhe kontributet qe perbejne ate akordohen ne Para (leke).

Neni 9

PERGJEGJESIA

Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise. Ortaket mbulojne humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributit te nenshkruar.

Neni 10

LEVIZJET E KAPITALIT

Ne vijim te veprimtarise kapitali i shoqerise mund te jete objekt ndryshimi (zmadhimi ose zvogelimi) sipas disponimit me vendim te shoqerise.

Ndryshimi i kapitalit shtrin efektet vetem mbi ortaket qe kane dhene pelqimin per kete ndryshim. Kur nga ndryshimi i kapitalit ndryshojne te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i nje kategorie kuotash, vlefshmeria e vendimit persa i perket kesaj kategorie i nenshtrohet pelqimit te ortakëve te prekur.

Zmadhimi i kapitalit behet me vendim asambleje ne nje nga format—Zmadhim kundrejt kontributeve te reja nga ortakë ose/dhe nga jo ortakë; Zmadhim i kufizuar; Zmadhim i autorizuar (vetem me vendim te posacem te asamblese); Zmadhim me aktive te shoqerise; Zmadhim nepermjet obligacioneve.

Zvogelimi i kapitalit behet me vendim asambleje ne nje nga format—Zvogelim ne zbritje te kapitalit ose zvogelim i vleres nominale te kuotave/aksioneve; Zvogelim i thjeshtezuar; Zvogelim me anullim kuotash/aksionesh.

Neni 11

KUOTAT DHE KALIMI I TYRE

Kuotat e shoqerise mund te zoterohen nga nje ortak ose ne bashkepronësi, ne menyre te barabarte ose jo. Ne rastin e kuotes qe zoterohet ne bashkepronësi, ne marredhenie me shoqerine keta persona trajtohen si nje ortak dhe te drejtat i ushtrojne nga nje perfaqesues i perbashket.

Kuotat jane lirisht te transferueshme,nga ortaku drejt shoqerise apo ndermjet vete ortakeve.Kalimi(transferimi) i kuotave tek personat e trete kushtezohet nga e drejta e parablerjes qe gezon shoqeria apo ortaket sipas rastit.Shoqeria qe nuk pranon blerjen e kuotave,nuk mund te pengoje qe ortaket personalisht t'i blejne keto kuota.Ne rast se shoqeria apo ortaket,brenda 2 muajve nga data e marrjes efektivisht dijeni nuk pergjigjen me shkrim per ushtrimin e te drejtes se parablerjes,atehere miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.Ne rast se shoqeria apo ortaket,brenda afatit te mesiperm deklarojne se do te ushtrojne te drejten e parablerjes,atehere duhet te blejne kuotat qe shiten brenda nje afati 1 mujor nga data e njoftimit per ushtrimin e te drejtes se parablerjes.Nese per faj te tyre nuk kryejne blerjen brenda ketij afati,e drejta e parablerjes humbet.Kalimi i kuotave tek te tretet nuk mund te behet ne kushte me te favorshme se ato qe i jane prezantuar shoqerise apo ortakeve te tjere,ne te kundert ka vend per anullim te transferimit dhe sipas rastit shperblimin e demit.Kalimi i kuotave qe zoterohen ne bashkepronesi i nenshtrohet fillimisht te drejtes se parablerjes se bashkepronareve te kuotes e nese keta refuzojne,shoqerise apo ortakeve,pastaj te treteve,sipas rregullimit te bere me lart.Sipas rastit kuotat mund te pjesetohen per shkak te kalimit te tyre.


KREU III  
ORGANET E SHOQERISE,VENDIMARRJA

Neni 12  
MARRREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

Ortaket gezojne te drejten e terheqjes se fitimit te realizuar ne raport me kuotat e zoteruara.Shperndarja e fitimit behet ne respektim te kerkesave ligjore ne fuqi.Shoqeria ruan te drejten te anulloje kuoten e zoteruar nga ortaku.Si shkaqe dhe procedura te anullimit do te zbatohen rastet e parashikuara ne ligj ose qe shoqeria do te vendose ne te ardhmen.Kuota anullohet me miratimin e ortakut perkates,me perjashtim te rastit kur per arsye objektive te arsyetuara,asambleja e ortakeve vendos te mos te merret ky miratim.

Neni 13  
ORGANET E SHOQERISE

Asambleja e pergjithshme eshte organi pergjegjes per marrjen e vendimeve qe kane te bejne me ceshtjet themelore sic percaktohet ne nenin 81 te Ligjit tregtar.Asambleja e pergjithshme mblidhet ne sesione te zakonshme te pakten nje here ne vit e thirrur sipas rastit nga administratoret apo ortaket.Parimisht mbledhjet organizohen ne seline e shoqerise,por kur ekzistojne arsye objektive mund te mbahen ne nje vend tjeter te caktuar nga thirrresi.Cdo ortak



ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet apo/dhe vendimet e asamblese. Ne ushtrimin e te drejtes per pjesemarrje, cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër, ose nje person i trete i zgjedhur prej tij. Asambleja mund te thirret nepermjet njoftimit me shkrim (dorazi, rekomande) ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi dergohet jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhje. Njoftimi permban vendin, datën, orën dhe rendin e dites. Per rastet kur konfirmohet rregullisht se nje ortak ndodhet jashte shtetit te territorit te vendit ku zhvillohet mbledhja, atehere duhet te caktohet nje afat i arsyeshem per datën e mbajtjes se mbledhjes. Vendimet e marra ne kundershtim me percaktimin e rregullave te thirrjes jane te pavlefshme, vetem nese ortakët shprehen dakort pavaresisht parregullsisë. Kane te drejte te therrasin mbledhjen e asamblese ortakët te cilet perfaqesojne te pakten 3% te kapitalit te shoqerise.

Neni 14



#### VENDIMARRJA

Vendimet e asamblese se ortakeve merren me shumice te zakonshme ose shumice te cilesuar. Cdo kuote e zoteruar eshte e barabarte me nje vote. Ky kriter vlen edhe per kuotat e zoteruara ne bashkepronësi. Vendimet e marra me shumice te zakonshme konsiderohen te vlefshme kur, ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave dhe vendimi merret nga me shume se gjysma e ortakeve pjesemarrës. Vendimet e marra me shumice te cilesuar konsiderohen te vlefshme kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50% te kuotave dhe vendimi merret nga  $\frac{2}{3}$  e votave te ortakeve prezent.

Ushtrimi i te drejtes se votes per ortakët jo te pranishem ne asamble, behet me shkrese ose nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakut votues. Nje ortak nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja shqyrton ne rend dite dhe merr vendim per ndonje nga rastet e parashikuara ne nenin 89 te Ligjit tregtare. Ne keto raste, kuota e ortakut perkates nuk llogaritet ne perqindjen e kuoromit te nevojshem qe kerkohet ne kete nen dhe nenin 12 te statutit. Vendimet e asamblese se ortakeve regjistrohen ne procesverbal dhe procedura perkatese ndiqet nen pergjegjesine e administratorit. Ky i fundit sigurohet edhe per pasqyrimin e tyre ne regjistrin e vendimeve te shoqerise. Te drejten per te kerkuar hetime te posacme apo shfuqizimin e vendimeve te parregullta dhe demshperblimin e ardhur sipas rastit, kane te drejte ta iniciojne subjektet e parashikuara ne nenin 91 dhe 92 te ligjit tregtare apo/dhe ortakët qe perfaqesojne te pakten 3% te kapitalit te shoqerise.

#### KREU IV

#### ADMINISTRIMI I SHOQERISE, KESHILLI I PUNEMARRRESVE



Neni 15  
ADMINISTRATORI

Administratori i shoqerise eshte personi fizik ortak ose jo ortak i shoqerise. Administratori gezon kompetencat e parashikuara ne nenin 95/3 te ligjit tregtar dhe ato kompetenca te tjera te parashikuara ne nene te posacme te ketij ligji.

Administratori mban te gjitha detyrimet qe burojne nga ligjet ne fuqi, nga neni 98 i ligjit tregtar por duke mos u kufizuar vetem aty, nga statuti dhe vendimet e shoqerise si dhe nga parimet e mirebesimit. Administratori ndjek procedurat e njoftimit te akteve te shoqerise ne institucionet kompetente sipas rastit, perfaqeson shoqerine dhe leshon autorizime perfaqesimi per ceshtje te natyrave specifike.


Administratori perjashtohet nga ato kompetenca qe sipas ketij statuti dhe ligjeve ne fuqi i perkasin ortakeve te shoqerise, per te cilat duhet autorizim special me shkrim e sidomos marreveshjeve me efekte financiare, detyrimi, barra te ndryshme, pasuri te paluajtshme, duke mos u kufizuar vetem ne keto.

Kufizimet e tagrave te administratorit te percaktuara ne statutin e shoqerise (i bere publik ne regjistrin tregtare te Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenet 21 dhe 61 te ligjit per "QKB"), konsiderohen te njohura nga te tretet ne perputhje me nenet 12 dhe 96 te ligjit tregtar. Administratori detyrohet te demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara asaj nga veprimtaria e gabuar, parregullt, kundraligjshme, ne distancim te politikave tregtare, etj. Administratorit i takon rimbursimi i shpenzimeve te bera per arsye pune dhe/apo shperblime te vecanta qe sipas rastit akordohen me vendim te zakonshem te shoqerise. Shoqeria mund te kete dy ose me shume administrator. Ne rast te administrimit me shume persona, shoqeria ne momentin e emerimit do te percaktoje me vendim tagrat e secilit dhe menyren e ushtrimit te funksioneve te administratorit. Shkarkimi i administratorit nga funksioni, mbetet prerogative e asamblese se zakonshme te shoqerise. Administratori, ka te drejte qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te shoqerise, te marre ne pune shtetas te ndryshem, duke lidhur kontrate sipas kriterave qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi te miratuar me Ligjin Nr.7961 ,dt.12.07.1995 dhe me Ligjin Nr.7703,dt.11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore" si dhe ne pershtatje me rregullat e brendshme te disiplines dhe te punes te percaktuara nga vete punedhenesi.

Emerimi i administratorit behet me afat **5 vjet** me te drejte ripertesitje.

**Administratori i vetem caktohet Z.KLOANDI HANELLI.**

Neni 16  
KESHILLI I PUNEMARRESVE



Ky ligj parashikon detyrimin e pranise se keshillit te punemarresve,keta te fundit kane te drejte te krijojne strukturat perkatese dhe rregulloret e brendshme te organizimit dhe funksionimit te tyre.Perfaqesuesi i keshillit te punemarresve nderton dhe shkemben informacion me perfaqesuesin ligjor te shoqerise per ceshtjet ne interes te tyre.

KREU V  
LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

Neni 17

Cdo ortak mund te largohet nga shoqeria duke njoftuar perpara me shkrim shoqerine ku te jene permendur edhe shkaqet e largimit.Administratoret therrasin mbledhjen e asamblese,e cila merr ne shqyrtim nese do te likujdohet kuota si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.Ortaku gezon te drejtat qe njeh ligji kur shkaqet e largimit jane te arsyeshme,ne te kundert ai detyrohet te demshperbleje shoqerine per deme eventuale te shkaktuara.

Neni 18

Asambleja e zakonshme mund te kerkoje perjashtimin nga shoqeria te ortakut kur ekzistojne shkaqe te arsyeshme per kete perjashtim.Kerkesa i drejtohet gjykates e cila vendos nese arsytet e pretenduara legjitimojne ose jo perjashtimin e ortakut. Shoqeria dhe ortakut kane te drejte t'i kunderdrejtojne njeri-tjetrit pretendime per demshperblim.Te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga cilesia e ortakut shuhen ne daten e largimit ose te vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjashtimin.

KREU VI  
VITI FINANCIAR,LLOGARITE VJETORE,NDARJA E FITIMEVE

Neni 19  
VITI FINANCIAR,LLOGARITE VJETORE

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.Llogarite vjetore,inventari,relacionet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht,nga eksperti kontabel i autorizuar,miratohen nga asamblea me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.Miratimi



i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behen brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 20  
DIVIDENTET

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve mbi fitimin. Shperndarja e fitimeve behet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

KREU VII  
BASHKIMI,NDARJA,PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 21  
BASHKIMI,NDARJA,PRISHJA

Shoqeria, si subjekt tregtar me personalitet juridik, me vendimin e asamblese se jashtezakonshme te ortakeve mund te vendosi bashkimin apo ndarjen e shoqerise. Modalitet per realizimin e ketij veprimi percaktohen rast pas rasti dhe ne perputhje me urdherimet ligjore ne fuqi. Shoqeria prishet me vendim te asamblese se pergjithshme dhe i behet e njohur te treteve publik apo privat sipas ligjit ne fuqi. Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i paafte ose vdes. Ne rast shitje te shoqerise kuotat e ortakut i kalojne ortakeve te tjere te shoqerise.

Neni 22  
LIKUJDIMI

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerone nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit Asambleja vendos, me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar, mbi bilancin perfundimtare financiare, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar. Ne rast shitje kuotash ose shitje totale te shoqerise te drejten ekskluzive e ka ortaku i vetem ose ortaket qe zoterojne mbi 3/4 te kuotave te shoqerise.



KREU VIII  
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23  
SHNDERRIMI I SHOQERISE

Shnderrimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose ne shoqeri komandite mund te kryhet vetem me miratimin unanim te ortakeve, ndersa shnderrimi ne shoqeri anonime, me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 24  
MOSMARREVESHJET


Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, do ti paraqiten per zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare.

Neni 25  
DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky Statut eshte hartuar ne Bilisht me, 03.09.2022, ne kater ekzemplare origjinale, duke patur te gjitha tekstet fuqi te barabarte ligjore.

FIRMOSUR NGA ORTAKET E SHOQERISE:

ZJ. ENKELEJDA MARTINAJ

Enkelelda Martinaj  


Z. KLOANDI HANELLI

Kloandi Hanelli  
